



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË
FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT
TË UJËRAVE TË NDOTURA
KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR**

VENDIM

Nr.44, datë 13.06.2018

PËR LICENCIMIN E SH. A. UJËSJELLËS KANALIZIME KURBIN

Në zbatim të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", VKM nr. 958, datë 06.05.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence", si dhe Rregullores së licencimit miratuar me vendim të KKRR nr. 29 datë 08.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar dhe pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Teknike Ekonomike, mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kurbin sh.a. për rinovim licence dhe për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit të largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

Konstatohet se:

- Shoqëria Ujësjiellës Kurbin është licencuar me vendim të KKRR nr. 39 datë 23.09.2016, për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit me ujë për konsum publik me afat 4 vjeçar.
- Me anë të shkresës nr. 259 prot. datë 10.05.2018 shoqëria paraqet kërkesën për rinovim licence për efekt të shtimit të kategorisë së shërbimit për largimin e ujërave të ndotura, shtim të vlerës së kapitalit dhe ndryshim i emrit të shoqërisë;
- Aplikimi i shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Kurbin sh.a plotëson kërkesat e parashikuara në Rregulloren e Licencimit konkretisht:
 - Formati i aplikimit është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Janë bërë ndryshimet në dokumentin e QKB mbi emrin e subjektit dhe shtimi i objektit për aktivitetin e largimit të ujërave të ndotura;
 - Dokumentacioni juridik dhe administrativ është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator,

VENDOSI:

1. Licencimin e operatorit Ujësjetllës Kanalizime Kurbin sh.a me:
Drejtues Ligjor Alfred Prodani
Drejtues Teknik Julinda Elezi
2. Operatori sh.a. Ujësjetllës Kanalizime Kurbin autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategorinë:

Kategoria A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria C, Për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori janë njësitet administrative të Bashkisë Kurbin, si më poshtë:
 - a) Njësitet administrative: Laç
 - b) Mamurras
 - c) Milot
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4 (katër) vjeçare.
5. Vendimi i Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 23.09.2016, "Për licencim sh.a Ujësjetllës Kurbin" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Ndriçim SHANI